

VENDIM
Nr. 143, datë 26.12.2014

**PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HIDROCENTRALET EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW, PËR
VITET 2013 DHE 2014**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 26.1.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 e 2014,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 e 2014, do të jetë 7.53 lekë/kWh.

2. KESH sh.a. dhe çdo i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, të akomodojnë efektet financiare të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti